

Data: 19/10/2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM – VENDOSJA E SISTEMIT TË MONITORIMIT ONLINE TË VAZHUESHËM TË VIBRIMEVE TË HIDRO-TURBINAVE, GJENERATORIT DHE MONITORIMIT ONLINE TË HAPËSIRËS AJRORE (AIR GAP) MIDID STATORIT DHE ROTORIT TË GJENERATORËVE PËR 5(PESË) AGREGATËT E HEC VAU DEJËS”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME -39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 260,000,000 (Dyqind e gjashtëdhjetë milion) Lekë, pa TVSH ose 2,457,466 (Dy milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 19/10/2023 është 105.80 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të

shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për sistemin që do të ofrojë.

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, për mallrat që do të ofertojë, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në ëbsite të tyre përkatës.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- ✚ Minimumi 1(një) Inxhinier Elektrik;
- ✚ Minimumi 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- ✚ Minimumi 1(një) punonjës të diplomuar në një nga fushat Informatike/ Teknologji informacioni / Elektronik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diploma;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Gusht 2023 – Tetor 2023;

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me

sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar.

Konkretisht:

- ✚ Është kërkuar 1(një) Inxhinier Elektrik, pasi instalimi i sistemit përfshin punime në gjenerator, punimet për integrimin e sistemit në kontroll monitorimin dhe integrimin e matjeve elektrike. Rrjedhimisht për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet që operatori ekonomik ofertues të ketë në staf inxhinierin elektrik.
- ✚ Është kërkuar 1 (një) Inxhinier Mekanik, pasi referuar kontratës objekt prokurimi, vend instalimi i sensorëve në aksin e agregatit dhe në hapësiart ajrore të gjeneratorit kërkon nivel të lartë profesional nga ana mekanike dhe kompetent për gjeneratorët dhe hidro-turbinat e prodhimit të energjisë elektrike. Për realizimin me sukses të kësaj kontrate operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka kapacitetet teknike për realizimin e punimeve mekanike.
- ✚ Kërkesa që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në staf 1(një) punonjës të diplomuar në një nga fushat Informatike/ Teknologji informacioni / Elektronik, është i nevojshëm pasi objekti prokurimit përfshin një sistem monitorimi që është i përbërë nga sensor dhe shndërrues elektronik të sinjaleve.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar se sistemi i cili do të furnizojë do të jetë në përputhje me standardet si më poshtë **ose ekuivalent:**

- ✚ ISO 20816-5:2018 - Vibrimet mekanike - Pjesa 5;
- ✚ ISO 13373-3:2015 - Monitorimi i gjendjes dhe diagnostikimi i agregateve - Pjesa 3;
- ✚ ISO 13373-3:2017 - Teknikat diagnostikuese për komplet maknerish, pjesa hidraulike në impiantet e prodhimit të energjisë;
- ✚ SSH EN IEC 60034-14:2018 - Makinat elektrike rrotulluese - Pjesa 14;
- ✚ SSH EN IEC 60034-33:2022- Makinat elektrike rrotulluese - Pjesa 33;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri referuar edhe legjisllacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të dëshmuar se prodhuesi plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga standartet, në lidhje me sistemet e montorimit të vibrimeve dhe hapësisrës ajrore “Air Gap”.

- ✚ ISO 20816-5:2018 - është e nevojshme pasi objekti i prokurimit është pikërisht agregati për prodhimin e energjisë;

- ✚ ISO 13373-3:2015 - është e nevojshme pasi ka shumë rëndësi metodika që përdoret për diagnostifikimin dhe nxjerrjen e rezultateve për pjesën mekanike të agregatit;
- ✚ ISO 13373-3:2017 - është e nevojshme pasi në objekt të specifikimeve teknike është përfshirë monitorimi pjesës hidraulike të turbinës;
- ✚ SSH EN IEC 60034-14:2018 – është standart që duhet të plotësohet për makinat rrotulluese në lidhje me matjen dhe përcaktimin e limiteve për alarm dhe stakim të agregatit.
- ✚ SSH EN IEC 60034-33:2022 – është standart që duhet të plotësohet pasi në HEC Vau Dejës sistemi do të impementohet konkretisht në gjeneratorë hidro.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- ✚ ISO 27001:2013 “Sistemi i sigurisë së informacionit”;
- ✚ ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” - Ky standart është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 27001:2013 “Sistemi i sigurisë së informacionit”- Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Specifikimet teknike janë hartuar që të instalohet një sistem monitorimi, i cili duhet të përfshijë të gjitha pajisjet e nevojshme për funksionimin e tij, për secilin nga 5 (pesë) Agregatët, si: sensorët e vibrimeve absolute dhe relative, sensorët e Air Gap, sensorin e fluksit magnetik, automatet dhe kabllot e ushqimit me energji elektrike të pajisjeve, kabllot e sinjalit, kabllot e komunikimit dhe ndërlidhjes me serverin qendror, sensor sinkronizimi për secilin nga 5 Agregatët, kutitë për klemat e kablllove dhe strehimin e pajisjeve, pajisja modulare kryesore e procesimit dhe monitorimit në kohë reale të matjeve, që do të furnizohet dhe instalohet për secilin nga 5 Agregatët me 16 kanale hyrëse të sinjalit të sensorëve dhe karta shtesë për të siguruar hyrjet për sensorët absolutë të vibrimeve. Një server qendror ku do të instalohet dhe konfigurohet programi i menaxhimit të matjeve online të vazhdueshme të vibrimeve dhe Air Gap nga sensorët për të 5-të Agregatët, paraqitja grafike dhe përdorimi i matjeve për raporte të ndryshme. Furnizimi dhe instalimi i 1 (një) Workstation në sallën e komandës së HEC Vau i Dejës, i cili do të konfigurohet të komunikojë me serverin qendror të sistemit që do të instalohet dhe do të shërbejë për mundësinë e vizualizimit dhe monitorimit të vibrimeve dhe Air Gap nga personeli teknik i HEC Vau i Dejës në sallën e komandës. Për të përmirësuar mbledhjen e informacionit, sistemi i ri që do të furnizohet dhe instalohet, duhet të jetë një sistem qendror monitorimi me mundësi zgjerimi, i aftë për të monitoruar vibrimet, parametrat elektrike, temperaturën, gjeometrinë dhe parametrat magnetikë. Ky sistem do të përdoret si një sistem monitorimi online me aftësi mbrojtëse dhe parandaluese, si dhe mund të përdoret për të parë të dhënat në kohë reale gjatë vënies në punë ose mirëmbajtjes së Agregatëve.

Në specifikimet teknike janë kërkuar standarte dhe ISO-t përkatëse, me të cilat sistemi duhet të jetë kompatibël, për të plotësuar të gjitha kërkesat për një monitorim të plotë dhe të sigurtë.

Njësia e Prokurimit